



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE

PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN PËRFUNDIMTAR
NË KUALIFIKIMIN PROFESIONAL “DIAGNOSTIKIM-MENAXHIM
NË AUTOSERVIS”

(Niveli V në KSHK¹, referuar Niveli V në KEK²)

Kodi: M1-V-23

TIRANË, 2024

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Programi orientues për provimet përfundimtare të kualifikimit profesional **”Diagnostikim-menaxhim në autoservis”**, **Niveli V në KSHK, referuar Niveli V në KEK**, përmban kompetencat më të rëndësishme dhe më përfaqësuese për këtë Kualifikim profesional, të trajtuara në modulet e detyruara të praktikës që i përket këtij niveli.

Ky program i ndihmon individët të përqendrohen në ato njohuri (koncepte, parime, ligjësi, procedura etj.) dhe kompetenca profesionale, që qëndrojnë në themel të profesionit për këtë nivel kualifikimi. Programi ndihmon, gjithashtu, edhe mësimdhënësit për organizimin e punës për përsëritjen dhe kontrollin përfundimtar të arritjeve të individit.

Për drejtuesit e të gjitha niveleve, këto programe krijojnë mundësinë e verifikimit paraprak të shkallës së përgatitjes përfundimtare të individëve brenda një institucionit, i cili mund të realizohet duke zhvilluar testime përmblendhëse.

Gjatë punës me këto programe kujdes duhet t’i kushtohet përvetësimit të njohurive dhe kompetencave themelore për këtë nivel kualifikimi, të cilat bëjnë të mundur integrimin e individit në botën e punës, por edhe që krijojnë vazhdimësinë e shkollimit të tij/saj në shkollat e larta.

Gjatë përgatitjes së individëve për provimet përfundimtare, është e rëndësishme që herë pas here mësimdhënësit të zhvillojnë testime, me teste teorike dhe praktike, që mund t’i hartojnë vetë. Gjatë hartimit të përmbajtjes së tyre duhen mbajtur parasysh njohuritë dhe kompetencat e përfshira në këtë program, si edhe udhëzimet për vlerësimin.

Programi orientues përbëhet nga dy pjesë:

- programi orientues për provimin e teorisë profesionale të integruar;
- programi orientues për provimin e praktikës profesionale të integruar.

A. Programi orientues për Provimin e Teorisë Profesionale të integruar

Programi orientues për provimin e teorisë profesionale të integruar, në Kualifikimin Profesional **”Diagnostikim-menaxhim në autoservis”**, **Niveli V në KSHK, referuar Niveli V në KEK**, është hartuar duke u mbështetur në rezultatet e të nxënit, të cilat mbulojnë çështje teorike profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës. Ky program përmban rreth 30% të vëllimit të këtyre RN-ve që mbulojnë dhe përmbajnë çështje teorike profesionale.

Njohuritë profesionale të përfshira në programin orientues dhe peshat e tyre përkatëse janë:

Tabela 1: Modulet dhe peshat përkatëse në programin orientues:

Nr.	Modulet	Peshat në %
1	Diagnostikimi kompjuterik i parregullsive në sistemet elektrike, elektronike dhe mekatronike të automjetit	15
2	Diagnostikimi i mekanizmave dhe sistemeve të motorit	15
3	Diagnostikimi i sistemit të transmetimit të fuqisë mjetet e transportit	15
4	Diagnostikimi i sistemit të frenimit drejtimit të automjetit	10

5	Diagnostikimi i sistemit të drejtimit të automjetit	10
6	Diagnostikimi i sistemeve ndihmëse të automjetit	10
7	Diagnostikimi i sistemit të ecjes dhe varjes së automjetit	10
8	Diagnostikimi i sistemeve të automjeteve elektrike dhe hibride	15
	TOTALI	100%

Rezultatet e të nxënit për njohuritë profesionale të përfshira në programin orientues, janë:

1. Rezultatet e të nxënit nga moduli “**Diagnostikimi kompjuterik i parregullsive në sistemet elektrike, elektronike dhe mekatronike të automjetit**”:
 - Të tregojë elementet përbërëse të sistemeve elektrike, elektronike dhe mekatronike të automjeteve, si dhe funksionet e tyre.
 - Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të lëshimit dhe tregojë parregullsitë kryesore e shkaqet e tyre.
 - Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të ndriçim-sinjalizimit dhe tregojë parregullsitë kryesore e shkaqet e tyre.
 - Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të ndriçim-sinjalizimit dhe tregojë parregullsitë kryesore e shkaqet e tyre.

2. Rezultatet e të nxënit nga moduli “**Diagnostikimi i mekanizmave dhe sistemeve të motorit**”:
 - Të rendisë parregullsitë kryesore të sistemeve dhe mekanizmave të motorëve të automjeteve
 - Të përshkruajë shkaqet më të mundshme të parregullsive të sistemeve dhe mekanizmave të motorëve të automjeteve
 - Të përcaktojë procedurat për diagnostikimin e sistemit të vajisjes.
 - Të përcaktojë procedurat për diagnostikimin e sistemit të ftohjes me lëng të motorit
 - Të përcaktojë procedurat për diagnostikimin e sistemit të ushqimit të motorit “otto”.
 - të përcaktojë procedurat për diagnostikimin e sistemit të ushqimit të motorit “diesel”.
 - të përcaktojë procedurat për diagnostikimin e sistemit të ushqimit me injeksion benzine.

3. Rezultatet e të nxënit nga moduli “**Diagnostikimi i sistemit të transmetimit të fuqisë në mjetet e transportit**”:
 - Të përshkruajë ndërtimin e përgjithshëm të elementeve të transmisionit të fuqisë së automjetit.
 - Të përshkruajë ndërtimin e friksionit, parregullsitë kryesore dhe shkaqet e tyre.
 - Të përshkruajë ndërtimin e kutisë së ndërrimit të shpejtësisë, parregullsitë kryesore dhe shkaqet e tyre.
 - Të përshkruajë ndërtimin e transmisionit kryesor, parregullsitë kryesore dhe shkaqet e tyre.
 - Të përshkruajë ndërtimin e diferencialit, parregullsitë kryesore dhe shkaqet e tyre.

4. Rezultatet e të nxënit nga moduli “**Diagnostikimi i sistemit të frenimit të**

- **automjetit”:**
 - Të përshkruajë ndërtimin he funksionimin e sistemit të frenimit të automjetit.
 - Të përshkruajë mekanizmin e sistemit të frenimit, parregullsitë kryesore dhe shkaqet e tyre.
 - Të përshkruajë mekanizmat e komandimit elektrik të sistemit të frenimit, parregullsitë kryesore dhe shkaqet e tyre.
5. Rezultatet e të nxënit nga moduli “**Diagnostikimi i sistemit të drejtimit të automjetit”:**
- Të përshkruajë ndërtimin e sistemit të drejtimit të automjeteve dhe funksionimin e elementeve të tij.
 - Të përshkruajë mekanizmin e komandimit të sistemit të drejtimit, parregullsitë kryesore dhe shkaqet e tyre.
 - të përshkruajë sistemin e drejtimit me grup timoni hidraulik dhe elektrik, parregullsitë kryesore dhe shkaqet e tyre.
6. Rezultatet e të nxënit nga moduli “**Diagnostikimi i sistemeve ndihmëse të automjetit”**
- Të listojë sistemet ndihmëse të automjetit dhe funksionet e tyre.
 - Të përshkruajë ndërtimin e përgjithshëm të sistemeve ndihmëse të automjetit.
 - Të përshkruajë fshirëset e xhamave, parregullsitë kryesore dhe shkaqet e tyre.
 - Të përshkruajë mekanizmin e ajrit të kondicionuar/klimatizimit të kabinës së automjetit, parregullsitë kryesore dhe shkaqet e tyre.
7. Rezultatet e të nxënit nga moduli “**Diagnostikimi i sistemit të ecjes dhe varjes së automjetit ”:**
- Të përshkruajë ndërtimin e sistemit të ecjes dhe varjes së automjetit dhe funksionimin e elementeve të tij.
 - Të përshkruajë balestrat e kunderbalestrat, parregullsitë kryesore dhe shkaqet e tyre.
 - Të përshkruajë amortizatorët, parregullsitë kryesore dhe shkaqet e tyre.
 - Të përshkruajë gomat, parregullsitë kryesore dhe shkaqet e tyre.
 - Të përshkruajë disqet, parregullsitë kryesore dhe shkaqet e tyre
 - Të përshkruajë mocot, parregullsitë kryesore dhe shkaqet e tyre
8. Rezultatet e të nxënit nga moduli “**Diagnostikimi i sistemeve të automjeteve elektrike dhe hibride”:**
- Të përcaktojë procedurat për të bërë diagnostikimin e sistemeve shtytëse të automjeteve elektrike dhe hibride
 - të përcaktojë procedurat për të bërë diagnostikimin e sistemit elektrik të tensionit të lartë, baterisë dhe sistemit të karikimit të automjetit elektrik ose hibrid.
 - të përcaktojë procedurat për të bërë diagnostikimin e sistemit të menaxhimit termik të automjetit elektrik ose hibrid.

Udhëzime për vlerësimin:

Provimi i teorisë profesionale të integruar do të jetë me shkrim. Rekomandohet që provimi të kryhet me anë të një testi të parapërgatitur nga vetë shkolla. Testi duhet të mbulojë rreth 80% të rezultateve mësimore të listuara më sipër. Gjithashtu, rekomandohet që 50% e njësive të testit të jenë me zgjedhje të shumëfishtë (deri në 4 alternativa) dhe pjesa tjetër të jenë njësi testi në formën e pyetjeve me përgjigje të hapur (nxënësi duhet të japë edhe argumentet për përgjigjen e dhënë nga ana e tij/saj), pyetje me përgjigje të kufizuar etj.

Njësitë e testit duhet të jenë të niveleve të ndryshme të vështirësisë, duke ndjekur skemën me tri nivele, si më poshtë:

Niveli I: Rikujtimi / Të kuptuarit
Niveli II: Zbatimi / Analiza
Niveli III: Sinteza/ Vlerësimi

Shkolla përcakton numrin maksimal të pikëve të testit dhe harton skemën përkatëse të vlerësimit. Në tabelën në vijim, rekomandohet që numri maksimal i pikëve të jetë 50 dhe shpërndarja e pikëve të bëhet në raport me peshën e çdo lënde dhe nivelet e vështirësisë.

Tabela 2: Ndarja e pikëve sipas peshës së çdo lënde dhe niveleve

Nr .	Modulet	Peshat e module ve në %	Pikët për çdo modul	Ndarja e pikëve sipas niveleve të vështirësisë		
				Niveli I 40% e pikëve	Niveli II 40% e pikëve	Niveli III 20% e pikëve
1	Diagnostikimi kompjuterik i parregullsive në sistemet elektrike, elektronike dhe mekatronike të automjetit	15	9	4	4	1
2	Diagnostikimi i mekanizmave dhe sistemeve të motorit	15	9	4	4	1
3	Diagnostikimi i sistemit të transmetimit të fuqisë mjetet e transportit	15	9	4	4	1
4	Diagnostikimi i sistemit të frenimit drejtimit të automjetit	10	6	2	2	2
5	Diagnostikimi i sistemit të drejtimit të automjetit	10	6	2	2	2
6	Diagnostikimi i sistemeve ndihmëse të automjetit	10	6	2	2	2
7	Diagnostikimi i sistemit të ecjes dhe varjes së automjetit	10	6	2	2	2
8	Diagnostikimi i sistemeve të automjeteve elektrike dhe hibride	15	9	4	4	1

TOTALI	100%	60 pikë	24 pikë	24 pikë	12 pikë
---------------	-------------	----------------	----------------	----------------	----------------

Përcaktimi i pikëve për çdo njësi testi bëhet duke pasur parasysh tipin e njësive të testit. Kështu, njësitë e testit me zgjedhje të shumëfishtë marrin 1 (një) pikë përkundërt përgjigjes së paracaktuar të saktë, por mund të marrin edhe 2 (dy) pikë nëse përmbajnë jo thjesht rikujtim por edhe analizë dhe llogaritje; njësitë me përgjigje të hapur marrin aq pikë sa kërkesa kanë brenda për brenda tyre (duke mbajtur parasysh edhe argumentimin nga nxënësi); njësitë me përgjigje të kufizuar dhe llojet e tjera të njësive të përfshira në test, marrin aq pikë sa gjykohet nga grupi hartues dhe kjo lidhet me kërkesat që parashtrihen në pyetje dhe niveli i vështirësisë.

Së fundi, skema e vendosjes së notës kundërt pikëve të fituara rekomandohet të jetë si më poshtë:

Pikët e fituara	Notat
0 - 10	4
11 - 15	5
16 - 20	6
21 - 25	7
26 - 30	8
31 - 35	9
36 - 60	10

Përmbajtja e programit për Provimin e Praktikës Profesionale të integruar

Programi orientues për provimin e praktikës profesionale të integruar, në kualifikimin profesional "Gjeodezi", **Niveli IV në KSHK** është hartuar duke u mbështetur në listën e kompetencave profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës.

a) Lista e kompetencave profesionale për të cilat duhet të vlerësohen nxënësit, **detyrat e punës** dhe **pikët** për secilën kompetencë:

Nr.	Kompetencat profesionale	Detyrat e punës	Pikët
1	Të realizojë punime të diagnostikimit me kompjuter në sistemet elektrike elektronike dhe mekatronike të automjetit	Detyra 1: Punime diagnostikimi me kompjuter në sistemet elektrike elektronike dhe mekatronike të automjetit.	15
2	Të realizojë punime të diagnostikimit në mekanizmat dhe sistemet e motorit	Detyra 2: Punime diagnostikimi në mekanizmat dhe sistemet e motorit	20
3	Të realizojë punime të diagnostikimit në sistemin e transmetimit të fuqisë në mjetet e transportit	Detyra 3: Punime diagnostikimi në sistemin e transmetimit të fuqisë në mjetet e transportit	10
4	Të realizojë punime të diagnostikimit në elementët e sistemit të frenimit dhe drejtimit të automjetit.	Detyra 4: Punime diagnostikimi në elementët e sistemit të frenimit dhe drejtimit	10

5	Të realizojë punime të diagnostikimit në sistemet ndihmëse të automjetit.	Detyra 5: Punime diagnostikimi në sistemet ndihmëse të automjetit.	15
6	Të realizojë punime të diagnostikimit në sistemin e ecjes dhe të varjes së automjetit	Detyra 6: Punime diagnostikimi në sistemin e ecjes dhe të varjes së automjetit.	10
7	Të realizojë punime diagnostikimi në sistemet e automjeteve elektrike dhe hibride	Detyra 7: Punime diagnostikimi në automjeteve elektrike dhe hibride	20
Shuma			100

b) Skema e vlerësimit me nota:

Pikët e fituara	Notat
0 - 40	4
41 - 50	5
51 - 60	6
61 - 70	7
71 - 80	8
81 - 90	9
91 - 100	10

Shënime:

- Provimi praktik do të realizohet me anë të metodës së vlerësimit të nxënësve me “detyra pune”, në bazat e praktikave pranë shkollave profesionale për të gjitha ato procese, që garantojnë në mjediset e saj. Për procese që nuk garantojnë në bazën e praktikave të shkollës, ato mund të realizohen në mjedise reale pune (servise), që garantojnë kushtet për realizimin e tyre.
- Koha për realizimin e të gjitha detyrave duhet të jetë jo më shumë se **3 orë**, në përputhje kjo me Udhëzimin për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në AFP.
- Është e domosdoshme dhe shumë e rëndësishme që për çdo detyrë, në fillim të provimit të praktikës profesionale, nga mësimdhënësit (organizatorët e provimit) t’i kushtohet vëmendje Respektimit të Rregullave të Sigurimit Teknik dhe Mbrojtjes së Mjedisit gjatë gjithë kryerjes së detyrave për çdo nxënës.
- Gjithashtu, duhet t’i lihet hapësirë bashkëbisedimit profesional, ku komisioni drejton pyetje të parapërgatitura për proceset kyçe, por dhe në çdo rast kur e shikon të arsyeshme që duhet të ndërhyjë me pyetje, sepse bashkëbisedimi profesional është element i rëndësishëm i secilës prej kompetencave të listuara më sipër.
- Për çdo detyrë komisioni i vlerësimit duhet të përgatisë instrumentet e vlerësimit të detajuara, p.sh listë kontrolli, duke pasur parasysh programin e zhvilluar në këtë nivel, për të gjitha modulet e detyruara të praktikës profesionale, sipas kompetencave përkatëse të përfshira në skeletkurrikul.
- Instrumentet e vlerësimit për secilën detyrë duhet të përfshijnë të gjitha hapat e realizimit të saj, duke filluar nga përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës, higjienizimin e vendit dhe mjeteve të punës, etj. Gjithashtu, është e rëndësishme të vlerësohet realizimi i standardeve dhe respektimi i procesit në kohë.
- Për çdo detyrë komisioni duhet të përfshijë në vlerësim një element shumë të rëndësishëm, i cili është sistemimi dhe pastrimi i vendit dhe i mjeteve të punës pasi nxënësi ka realizuar dhe përfunduar detyrën.

- Për çdo detyrë komisioni i provimit përfshin në vlerësim edhe disa kompetenca të përgjithshme, të cilat janë të rëndësishme, si vetëkontrolli, manifestimi i guximit, angazhimi fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme, komunikimi, bashkëpunimi në grup, bashkëveprimi etj.
- Është e rëndësishme, që nxënësit të pajisen me një material udhëzues, ku të përcaktohen detyrat që do të kryejnë, mënyra e vlerësimit të tyre, koha që duhet të kenë në dispozicion. Gjithashtu, mund t'u jepen tabela ndihmëse, ku paraqiten vlera për matje të caktuara sipas detyrave përkatëse, etj.
- Komisioni i provimit për të gjitha detyrat parapërgatit tezat e provimit ku nxënësi/grupi në mënyrë të rastësishme zgjedh njërën prej tyre. Komisioni i provimit duhet përgatisë paraprakisht instrumentin e vlerësimit me procedurat/hapat/etapat e kryerjes së detyrave. Komisioni nuk duhet të ndërhyjë gjatë zhvillimit të provimit.
- Vlerësimi i të gjitha detyrave bëhet me listë kontrolli në bazë të instrumenteve përkatëse të vlerësimit. Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës. Realizimi i pranueshëm i detyrës do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Udhëzime për realizimin e **Detyrës 1: “Punime diagnostikimi me kompjuter në sistemet elektrike, elektronike dhe mekatronike të automjetit”.**

Kjo detyrë do të kryhet në mjediset e praktikës profesionale për shërbimet e automjeteve ose në servise private për shërbime elektroauto.

Nxënësi duhet të kryejë të paktën **një** punim diagnostikimi në njërin nga sistemet elektrike elektronike dhe mekatronike të automjetit (burimet e energjisë elektrike, sistemi i lëshimit, sistemi i furnizimit me rrymë elektrike, sistemi i ndezjes së përzierjes djegëse, sistemi i ndriçim-sinjalizimit, sistemi elektrik i pajisjeve ndihmëse,).

Nxënësit i vihen në dispozicion materialet dhe pajisje e nevojshme për realizimin e kësaj detyre, si kompleti i veglave, instrumentet matës që mundësojnë diagnostikim e sistemit elektrik të automjetit, aparatura diagnostikuese të sistemit elektrik të automjetit, automjeti mësimor, dokumentacion teknik dhe formularë që përdoren për aspektet financiare dhe të menaxhimit në punimet e diagnostikimit të sistemit elektrik të automjetit katalogë, manuale, etj.

Ai pasi bën përzgjedhjen e tyre, kryen procesin e diagnostikim në elementin e sistemit të përcaktuar nga komisioni. Nxënësi punon në mënyrë individuale dhe të pavarur dhe vëzhgohet nga komisioni vlerësues në të gjitha hapat e punës që kryen. Ai do të vlerësohet më anë të listës së kontrollit.

Udhëzime për realizimin e **Detyrës 2: “Punime diagnostikimi në mekanizmat dhe sistemet e motorit ”**

Kjo detyrë do të realizohet në repartin e shkollës për shërbime të motorëve të automjeteve, ose në servise private të motorëve të automjeteve.

Nxënësi duhet të kryejë të paktën **një** punim diagnostikimi në njërin nga mekanizmat e motorit me djegie të brendshme (mekanizmit bjellë-manivelë ose mekanizmit të shpërndarjes së gazeve) ose nga sistemet e motorit me djegie të brendshme (sistemit të vajosjes, të ftohjes, të ushqimit, të shkarkimit të produkteve të djegies).

Nxënësit i vihen në dispozicion materialet dhe pajisje e nevojshme për realizimin e kësaj detyre, si kompleti i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve që mundësojnë diagnostikimin mekanizmave dhe sistemeve të motorëve të automjeteve, aparatura diagnostikuese të

mekanizmave dhe sistemeve të motorëve të automjeteve, automjete mësimor në gjendje pune, me motorë “otto” dhe “diesel”, dokumentacion teknik dhe formularë që përdoren për aspektet financiare dhe të menaxhimit në punimet e diagnostikimit të mekanizmave dhe sistemeve të motorëve të automjeteve, katalogë, manuale, etj.

Ai pasi bën përzgjedhjen e tyre, kryen procesin e diagnostikimit në elementin e sistemit të përcaktuar nga komisioni. Nxënësi punon në mënyrë individuale dhe të pavarur dhe vëzhgohet nga komisioni vlerësues në të gjitha hapat e punës që kryen. Ai do të vlerësohet më anë të listës së kontrollit.

Udhëzime për realizimin e Detyrës 3: **“Punime diagnostikimi në sistemin e transmetimit të fuqisë në mjetet e transportit ”.**

Kjo detyrë do të realizohet në repartin e shkollës për shërbime xhenerike të automjeteve, ose në servise private për shërbime xhenerike të automjeteve.

Nxënësi duhet të kryejë të paktën një punim diagnostikimi në njërin nga në njërin nga elementët e sistemit të transmetimit të fuqisë së automjetit (friksion, kuti shpejtësie, transmision kardanik, transmision kryesor dhe gjysmëboshte).

Nxënësit i vihen në dispozicion materialet dhe pajisje e nevojshme për realizimin e kësaj detyre, si kompleti i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve matëse dhe diagnostikuese, automjet mësimor në gjendje pune, elementë të sistemit të transmetimit të fuqisë, dokumentacion teknik dhe formularë që përdoren për aspektet financiare dhe të menaxhimit në punimet e diagnostikimit, katalogë, manuale, etj.

Ai pasi bën përzgjedhjen e tyre, kryen procesin e diagnostimit në elementin e sistemit të përcaktuar nga komisioni. Nxënësi punon në mënyrë individuale dhe të pavarur dhe vëzhgohet nga komisioni vlerësues në të gjitha hapat e punës që kryen. Ai do të vlerësohet më anë të listës së kontrollit.

Udhëzime për realizimin e Detyrës 4: **“Punime diagnostikimi në elementët e sistemit të frenimit dhe drejtimit ”**

Kjo detyrë do të realizohet në repartin e shkollës për shërbime xhenerike të automjeteve, ose në servise private për shërbime xhenerike të automjeteve.

Nxënësi duhet të kryejë të paktën një punim diagnostikimi në njërin prej elementëve të sistemit të frenimit dhe drejtimit.

Nxënësit i vihen në dispozicion materialet dhe pajisje e nevojshme për realizimin e kësaj detyre, si kompleti i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve matëse që mundësojnë diagnostikimin e elementëve të sistemit të frenimit, automjet mësimor në gjendje pune, elementë të sistemit të drejtimit dhe të frenimit, dokumentacion teknik dhe formularë që përdoren për aspektet financiare dhe të menaxhimit në punimet e diagnostikimit të elementëve të sistemit të frenimit, katalogë, manuale, etj.

Ai pasi bën përzgjedhjen e tyre, kryen procesin e diagnostikimit në elementin e sistemit të përcaktuar nga komisioni. Nxënësi punon në mënyrë individuale dhe të pavarur dhe vëzhgohet nga komisioni vlerësues në të gjitha hapat e punës që kryen. Ai do të vlerësohet më anë të listës së kontrollit.

Udhëzime për realizimin e Detyrës 5: **“Punime diagnostikimi në sistemet ndihmëse të automjetit”.**

Kjo detyrë do të realizohet në repartin e shkollës për shërbime xhenerike të automjeteve, ose në servise private për shërbime elektroaut të automjeteve.

Nxënësi duhet të kryejë të paktën një punim diagnostikimi në njërin prej **sistemeve ndihmëse**.

Nxënësit i vihen në dispozicion materialet dhe pajisje e nevojshme për realizimin e kësaj detyre, si kompleti i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve matëse që mundësojnë diagnostikimin e elementëve të **sistemeve ndihmese**, automjet mësues në gjendje pune, elementë nga sistemet ndihmese, dokumentacion teknik dhe formularë që përdoren për aspektet financiare dhe të menaxhimit në punimet e diagnostikimit, katalogë, manuale, etj. Ai pasi bën përzgjedhjen e tyre, kryen procesin e diagnostikimit në elementin e sistemit të përcaktuar nga komisioni. Nxënësi punon në mënyrë individuale dhe të pavarur dhe vëzhgohet nga komisioni vlerësues në të gjitha hapat e punës që kryen. Ai do të vlerësohet më anë të listës së kontrollit.

Udhëzime për realizimin e Detyrës 6: **“Punime të diagnostikimit në sistemin e ecjes dhe të varjes së automjetit ”**

Kjo detyrë do të realizohet në repartin e shkollës për shërbime xhenerike të automjeteve, ose në servise private për shërbime xhenerike të automjeteve.

Nxënësi duhet të kryejë të paktën një punim diagnostikimi në njërin prej elementëve të sistemit të ecjes dhe të varjes (amortizatorë, balestra, rrota, goma etj.)

Nxënësit i vihen në dispozicion materialet dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e kësaj detyre, si kompleti i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve matëse që mundësojnë diagnostikimin e elementëve të sistemit të ecjes dhe të varjes, automjet mësues në gjendje pune, dokumentacion teknik dhe formularë që përdoren për aspektet financiare dhe të menaxhimit në punimet e diagnostikimit të elementëve të sistemit të ecjes dhe të varjes, katalogë, manuale, etj.

Ai pasi bën përzgjedhjen e tyre, kryen procesin e diagnostikimit në elementin e sistemit të përcaktuar nga komisioni. Nxënësi punon në mënyrë individuale dhe të pavarur dhe vëzhgohet nga komisioni vlerësues në të gjitha hapat e punës që kryen. Ai do të vlerësohet më anë të listës së kontrollit.

Udhëzime për realizimin e Detyrës 7: **“Diagnostikimi në sistemet e automjeteve elektrike dhe hibride”**

Kjo detyrë do të realizohet në repartin e shkollës për shërbime të automjeteve elektrike dhe hibride ose në servise private të automjeteve ku kryhen shërbime të automjeteve elektrike dhe hibride.

Nxënësi duhet të kryejë të paktën një punim diagnostikimi në njërin prej elementëve të sistemeve të makinave elektrike apo hibride (sistemin elektrik të tensionit të lartë, sistemin e karikimit, sistemet shtytëse të automjeteve elektrike dhe hibride (motori/generatori elektrik, moduli elektronik i fuqisë, sistemi i menaxhimit termik (kompresori i ajrit të kondicionuar, moduli elektronik, sensorët e temperaturës, blloku i valvulave etj.).

Nxënësit i vihen në dispozicion materialet dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e kësaj detyre, si kompleti i veglave, pajisje dhe instrumente të nevojshme për diagnostikimin në automjetet elektrike dhe hibride. Testues për diagnostikimin dhe kalibrimin e sistemeve të automjeteve elektrike dhe hibride, formate të dokumentacionit teknik dhe financiar për shërbimet e automjeteve elektrike dhe hibride, katalogë të automjeteve, manuale, udhëzues pune, rregullore, pajisjet mbrojtëse individuale (doreza izoluese, këpucë dielektrike, veshje mbrojtëse, ekran kundër harkut. Nxënësi pasi bën përzgjedhjen e tyre, kryen procesin e diagnostikimit në elementin e sistemit të përcaktuar nga komisioni. Nxënësi punon në mënyrë individuale dhe të pavarur dhe vëzhgohet nga komisioni vlerësues në të gjitha hapat e punës që kryen. Ai do të vlerësohet më anë të listës së kontrollit.